

# SITUATA E AKTIVIZMIT STUDENTOR NË KOSOVË

**Autore:**

Fitore Metbala

Fatjeta Ibishi

# TABELA E PËRMBAJTJES

Metodologjia	3
Hyrje	4
Një historik i shkurtër i UP-së	6
Historiku i aktivizmit studentor në Kosovë (1968-1997)	7
Qëndrimet e studentëve lidhur me temat e këtij ligjërimi ishin:	8
Organizatrat studentore rajonale	9
Aktivizmi studentor në Shqipëri	9
Aktivizmi studentor në Maqedoni	10
Gjendja aktuale në fushën e arsimit	11
Procesi i Bolonjës	12
Historik i shkurtër	12
Definicione që lidhen me procesin e Bolonjës	12
Kosova dhe procesi i Bolonjës	14
Studentët dhe aktivizmi studentor	15
Puna në grupe	15
Lëvizja studentore	15
Lëvizja studentore si formë e organizimit studentor	15
Kauzat për të cilat mund të luftojë lëvizja studentore	16
Mjetet e ndikimit që mund të përdoren nga lëvizja studentore	17
Organizata formale	17
Organizata formale si formë e organizimit studentor	17
Kauzat për të cilat mund të luftojë organizata formale	18
Mjetet e ndikimit që mund të përdoren nga organizatat formale	18
Klubet studentore	18
Klubi si formë e organizimit studentor	18
Kauzat për të cilat mund të luftojë klubi	18
Mjetet e ndikimit që mund të përdoren nga klubi	19
Grupet studentore	19
Grupet si formë e organizimit studentor	19
Kauzat për të cilat mund të luftojë grupi	19
Mjetet e ndikimit që mund të përdoren nga grupi	19
Përfundimet	22
Rekomandimet	23

# METODOLOGJIA

Të dhënat e prezantuara në këtë dokument janë nxjerrë në tërësi nga aktivitetet e Shkollës Verore për Aktivizmin Studentor 2018, organizuar nga ORCA, që janë mbajtur nga datat 5 deri 10 shtator në Durrës.

Në shkollë kanë marrë pjesë gjithsej 34 (tridhjetë e katër) studentë nga Universiteti i Prishtinës, prej të cilëve 21 (njëzet e një) femra dhe 13 (trembëdhjetë) meshkuj.

Pjesëmarrësit kanë qenë nga fakultete e programe të ndryshme të studimeve, kryesisht studentë të vitit të parë dhe të dytë të studimeve, pa përjashtuar edhe studentë të viteve të tjera.

## **Qasja metodike e punës gjatë kësaj shkolle ka qenë kryesisht qasje cilësore e fokusuar në këto strategji:**

- Analizë kualitative (te gjendja e arsimit në Kosovë);
- Analizë krahasimore (e përdorur tek aktivizmi studentor në vend dhe rajon);
- Analizë interpretuese - Fenomenologjike;
- Mbledhja e të dhënave;

Metoda kuantitative/statistikore është përdorur vetëm në rastin e paraqitjes së gjendjes të arsimit në Kosovë.

Në tërësi zhvillimi i aktiviteteve është bërë mes dy qasjeve metodike, asaj normative përmes së cilës është munduar të nxirret nga pjesëmarrësit ideja se si “Duhet të jetë” arsimi dhe aktivizmi studentor, kurse përmes ligjërimeve, përvojave të ndara nga ligjëruesit e shkollës dhe statistikave të prezantuara, është shpalosur qasja empirike që ka shpjeguar/interpretuar realitetin politiko-social në vend, rajon e më gjerë në mënyrë sa më objektive, pra “çfarë është” gjendja.

Puna në grupe është bërë me qëllim të nxitjes së interaktivitetit dhe shkëmbimit të ideve mes tyre, e njëherësh të krijohet fryma e organizimit dhe ndarjes së përgjegjësisë mes studentëve.

Të dhënat e grumbulluara nga të gjitha aktivitetet e shkollës veçanërisht, analiza interpretuese nga ana e pjesëmarrësve, kanë shërbyer për t'i ekstraktuar qëndrimet ndaj gjendjes aktuale të arsimit në Kosovë, aktivizmit studentor, formave organizative, është arritur deri te përfundimet lidhur me këto tema si dhe janë nxjerrë rekomandimet kyçe.

# HYRJJE

Duke qenë se fokusi i punës së ORCA-s është ngritja e cilësisë në arsim, e me theks të veçantë edhe integriteti akademik, është vëzhguar me vëmendje modeli apo forma e organizimit studentor në çështjet që kontribuojnë në njërën apo formën tjetër për integritet, transparencë dhe ngritje të cilësisë së arsimit gjatë viteve të fundit, veçanërisht nga 2014 e tutje.

Çfarë ka dalë në pah është mungesa e koordinimit, madje deri në pikën përçarëse mes organizatave studentore, që në plan të shkaktimit të pasojës ka lënë studentët në pamundësi që t'i kanalizojnë shqetësimet e tyre pranë një adrese që do t'i merrte dhe ngriste ato në nivel të UP-së, konkretisht pranë strukturave kyçe udhëheqëse.

Në rrethana të tilla, studentët kanë pak hapësirë që problematikat kyçe me të cilat përballen t'i shtjellojnë, ose edhe në rastet e rralla kur ato shtjellohen nuk prodhojnë ndonjë rezultat të kënaqshëm, për shkak se serioziteti i organizatave studentore

aktuale lë për të dëshiruar sa i përket çështjes së gjithëpërfshirjes dhe punës aktive.

Vërehet qartë rezerva e tërësisë së studentëve karshi këtyre organizatave, sepse dyshohet që në instancë të fundit, pjesëmarrja dhe aktivizimi në to po përdoret që të prodhojë rezultate ose përfitime personale për udhëheqësit e tyre.

Përveç dyshimeve për përfitime/interesa personale, çka e ka rritur skepticizmin tek organizatat studentore ka qenë viti 2014, respektivisht protestat kundër ish-rektorit Ibrahim Gashi, gjatë të cilave është vërejtur diskrepancë e madhe mes tyre, përçarje dhe mosgatishmëri për bashkëpunim për çështjet që atëkohë kanë shqetësuar komunitetin arsimor, UP-në dhe tërë shoqërinë.

Ka qenë mjaft e dukshme që e vetmja gjë që i ka neutralizuar këto përçarje ishte përfshirja e shoqërisë civile në aksionet dhe organizimet e studentëve duke tërhequr numër më të madh të qytetarëve, që

njëherësh ka ndikuar edhe në mbulueshmëri më të madhe mediatike.

Në anën tjetër, sfera e problematikave me të cilat përballen studentët është aq e gjerë, sa kërkon angazhim shumëdimensional për ta zbutur ashpërsinë aktuale.

Përgjithësisht, struktura akademike e Universitetit të Prishtinës e ka bërë të zakonshme idenë e të qenët pos ligjërues/asistent, edhe të angazhuar politikisht, në poste të rëndësishme dhe në një laramani institucionale, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal.

Kjo ka ndikuar në krijimin e një konsensusi shoqëror se edhe organizatat studentore, shumica dërrmuese e tyre, kontrollohen nga grupe/parti të ndryshme politike.

Vështirësitë me të cilat ndeshen studentët përfshijnë ato administrative, infrastrukturore, si në nivel të qendrës studentore, ashtu edhe pranë njësive akademike ku u mungojnë hapësirat e

përshtatshme të leximit, punës, kabinetet dhe laboratorët, në aspektin e cilësisë së literaturës, që i bën ata të gjejnë alternativa të ndryshme që t'i marrin materialet e domosdoshme, qoftë edhe nga burime jokredibile, mungesa e përfaqësimit të denjë të tyre brenda UP-së, por edhe privimin indirekt nga e drejta e tyre themelore për një arsim cilësor.

Të tëra këto çështje janë vërejtur nga organizatat e shoqërisë civile, përmes hulumtimeve, takimeve me studentë dhe monitorimit të përgjithshëm të gjendjes në UP, por nuk janë adresuar e as përmirësuar.

ORCA ka ndjekur nga afër të gjitha zhvillimet në Universitetin e Prishtinës, në të gjitha aspektet, si atë të avancimit, trajtimit të integritetit akademik, por edhe aspektit se sa studentët po japin kontribut që t'i luftojnë dukuritë negative brenda institucionit ku studiojnë

dhe sa kanë vullnet që të inkuadrohen në procese për ta përmirësuar pozitën dhe kushtet për vetë studentët.

Në këtë cilësi, ORCA ka dhënë kontributin në krijimin e grupit joformal studentor "Grupi Anti-Seksist", që ka luajtur rol kyç në aktivitetet për adresimin e shqetësimit për seksizmin dhe ngacmimet seksuale në Universitetin e Prishtinës.

Meqë vërehet qartë një nevojë e vazhdueshme për mbështetje të tillë dhe nxitje për reagim më të planifikuar për çështjet që shqetësojnë studentët, pra për përmirësimin e frymës organizative, ORCA e ka parë të nevojshme mbajtjen e Shkollës Verore për Aktivizëm Studentor.

Ideja kyçe ka përfshirë nevojën e informimit të studentëve/organizatave studentore për larminë e mënyrave të organizimit, duke i njoftuar me historikun, ndikimin e

këtyre formave të aktivizmit në arsim dhe jo vetëm, por edhe duke pasur si qëllim krijimin e mundshëm të një organizimi në formë të koalicionit apo organizate të pavarur studentore, përmes së cilës do të adresoheshin çështjet me rëndësi për universitetin dhe studentin.

Kjo gjithashtu është parë si mundësi e mirë për t'i vërejtur opinionet e studentëve për gjendjen aktuale, formave organizative karshi të cilave kanë më shumë afinitet, propozimeve konkrete për zgjidhje rapide, vështrimeve kritike ndaj arsimit dhe cilësisë që ofron UP-ja, si dhe t'i ndajnë përvojat e tyre nga koha që janë regjistruar në këtë institucion, në mënyrë që të krijohet një pasqyrë më e qartë se çfarë vlerësimesh kanë për UP-në në përgjithësi dhe aktivizmin studentor në veçanti.

# NJË HISTORIK I SHKURTËR I UP-SË SHKËPUTUR NGA LIBRI

## ***“Universiteti i Prishtinës 1970-2005”***

Para themelimit të Universitetit të Prishtinës, institucionet e para të arsimit të lartë në Kosovë ishin: Shkolla e Lartë Pedagogjike në Prishtinë, pastaj u hap fakulteti i parë - Fakulteti Filozofik në Prishtinë (1960), e pas tij u hap Fakulteti Juridik-Ekonomik (1961)<sup>1</sup>. Pra, deri në vitin 1961 janë hapur 4 shkolla të larta dhe dy fakultete, në të cilat kanë studiuar 3.320 studentë. Pas tyre është hapur Fakulteti Teknik dhe ai i Mjekësisë<sup>2</sup>.

Me hapjen e Fakultetit Filozofik, Juridik-Ekonomik, Teknik dhe të Mjekësisë u krijuan kushtet themelore ligjore për themelimin e Universitetit të Prishtinës. Në këtë drejtim ndikuan edhe rrethanat objektive dhe ato politike në vend, sidomos pas Plenumit të Brionëve (1966), kur intensifikohen përpjekjet e popullit shqiptar të Kosovës për afirmim kombëtar dhe për realizimin e të drejtave politike, arsimore, etj. Ato kulmuan me demonstratë gjithëpopullore (1968), në të cilën u shtruan një varg kërkesash, siç ishin kërkesa për vetëvendosje, për Kushtetutë, për themelimin e një universiteti në Prishtinë, etj<sup>3</sup>.

Kuvendi themelues i Universitetit të Prishtinës u mbajt më 13 shkurt 1970, kurse dy ditë më pas, më 15 shkurt, u mbajt mbledhja solemne e Kuvendit për përrurimin e tij. Dita e 15 Shkurtit u shpall Dita e Universitetit të Prishtinës. Rektor i parë i tij u zgjodh prof. dr. Dervish Rozhaja<sup>4</sup>.

Ndërmjet viteve 1970-1980, në Universitetin e Prishtinës u diplomuan mbi 9500 studentë nga 46 profilet e tij dhe u mbrojtën mbi 100 disertacione të doktoratës.

Krahas rritjes së këtij institucioni, u intensifikua edhe dhuna ndaj tij, sidomos pas lëvizjes studentore në pranverën e vitit 1981. Në këtë aspekt, studentëve shqiptarë iu mohua e drejta e studimit, dhe u përjashtuan nga studimet 568 studentë. Në vitin 1990 u nxor vendimi për masat e dhunshme në Universitetin e Prishtinës nga Kuvendi i Republikës së Serbisë, ndërsa në qershor 1991 u futën masat e dhunshme në Universitet dhe në fakultete.

---

1 Këto informata janë shkëputur nga libri “Universiteti i Prishtinës 1970-2005”, Botim i veçantë i Universitetit të Prishtinës, viti i botimit 2005, fq. 12-13.

2 Po aty, fq. 14

3 Po aty, fq. 15

4 Po aty, fq. 16

# HISTORIKU I AKTIVIZMIT STUDENTOR NË KOSOVË (1968-1997)

Meqë qëllimi i dizajnit të programit të Shkollës Verore për Aktivizëm ka qenë krijimi i idesë se çfarë ka qenë organizimi studentor deri në ditët e sotme dhe nxitja e një reagimi më të organizuar nga studentët e sotëm, ka qenë i domosdoshëm prezantimi i shkurtër i historikut.

Shkëlzen Gashi<sup>5</sup> ka përmbledhur ngjarjet kyçe që kanë shënuar lëvizjet studentore për çështjet që kanë brengosur komunitetin tonë shoqëror, duke përfshirë aspektin kohor nga vitet '68' e deri te ngjarjet dhe format më të vonshme të organizimit studentor.

Është përshkruar demonstrata e **1968-ës**, mosekzistimi i Universitetit të Prishtinës, por vetëm i disa degëve në kuadër të Universitetit të Beogradit. Çfarë nuk mund të anashkalohej për organizimet e asaj kohe është nevoja e ngritur nga

<sup>5</sup> Shkëlzen Gashi ka studiuar shkencë politike, është autor i disa librave dhe si student ka qenë i angazhuar për ngritjen e zërit për reforma në UP (vitet 2001-2005).

qytetarët për një universitet më vete, që gjuha shqipe ta ketë statusin e gjuhës zyrtare dhe mbi të gjitha si kërkesën kryesore kishin statusin e Kosovës, pra kyçe ka qenë thirrja për "Kosovën Republikë". Për shkak të këtyre kërkesave, këto demonstrata kanë gëzuar përkrahje edhe nga personalitete udhëheqëse politike, edhe pse në mënyrë indirekte.

Pra, studentët kanë mundur ta vërejnë natyrën e ndryshme të kërkesave të asaj kohe, që rezultoi në konsensusin e përgjithshëm se varësisht nga stadi i zhvillimit shoqëror, përkatësisht gjendjes në vend, kanë lindur edhe kërkesat për të cilat është bërë bujë atëkohë.

Më pas janë ilustruar sukseset e demonstratave të **1968-ës**, për shkak të realizimit të shumicës së kërkesave, nisur nga ajo për njohjen e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare, krijimin e universitetit në Kosovë, përdorimin e simboleve kombëtare paçka se kërkesa për njohjen e Kosovës si

republikë është refuzuar, e megjithatë Kosova e fitoi statusin e autonomisë.

Demonstratat e **1981-ës** u janë përshkruar studentëve për shkak të rëndësisë organizative që kanë pasur. Në mars '81, fillimisht kanë protestuar rreth 400 studentë, kryesisht për kushtet e këqija në mensë dhe universitet, por në fund të marsit në organizimin e protestës së dytë, numri i pjesëmarrësve u rrit dhe kapi 4000 persona. Rritja e numrit të pjesëmarrësve ka vazhduar edhe në demonstratat e prillit të '81-tës, por njëjtë edhe propaganda serbe kundër Kosovës dhe shqiptarëve, pa u kursyer në përdorimin e mjeteve.

Sa i përket numrit të masës pjesëmarrëse, pjesëmarrësit e shkollës u njoftuan me historikun e demonstratave të **1989-ës**, ku në një rën prej tyre morën pjesë rreth 400 mijë njerëz, të mbledhur nga të gjitha trevat e Kosovës. Pavarësisht numrit të madh të pjesëmarrësve dhe kërkesave të paraqitura prej tyre, nuk rezultoi në realizimin e tyre madje

gjatë viteve të 90-ta, Serbia ka mbyllur shkollat, spitalet, ka larguar 50 mijë njerëz nga puna dhe janë vrarë 30 protestues.

Për të ilustruar se pavarësisht heshtjes 5-vjeçare, studentët kosovarë nuk kanë hequr dorë nga lufta për t'i realizuar kërkesat e tyre, u prezantua historiku i demonstratave të **1997-ës**, bashkë me rolin e figurave kyçe si Ejup Statovci, Bujar Dugolli e Albin Kurti. Kërkesat kyçe kishin të bëjnë me lirin e hapësirave universitare, por pavarësisht marrëveshjes objektet nuk janë liruar, policia ka intervenuar brutalisht dhe ka arrestuar pjesëmarrësit

e demonstratave.

Nga historiku i këtyre organizimeve mund të krijohej një perceptim më konkret se si studentët në atë kohë, me gjithë vështirësitë, kanosjet që kanë shkuar deri te rrezikimi i jetës, nuk kanë hequr dorë nga paraqitja e kërkesave, janë mobilizuar me vetëdijen se çfarë po humbisnin dhe me vullnetin për t'i ndaluar ato procese të dëmshme për studentin në veçanti dhe Kosovën në përgjithësi.

Sa i përket organizimit studentor për periudhën e pasluftës, përkatësisht viteve 2002-2005, studentët janë njoftuar

se për cilat çështje u shfaq nevoja për tubime dhe aktivitete. Brengat kyçe të kësaj periudhe kanë përfshirë: gjendjen e rëndë në UP, mungesë e literaturës, mungesa e revistave akademike, dukuria e plagjiaturës dhe hapësirave të leximit.

Nga ligjërimi për aktivizmin e këtyre viteve, është kuptuar që edhe pse organizimi në këtë periudhë bëhej pa frikën e represionit siç ishin demonstratat në vitet '60, '80 dhe '90, studentët u përballën me etiketime që kryesisht përfshinin akuza për ndikime apo ngjyrimë partiake të këtyre aktiviteteve.

## ***Qëndrimet e studentëve lidhur me temat e këtij ligjërimi ishin:***

- Dukuria që të mos ishte e qartë kush ishte organizator i demonstratës vazhdon edhe në ditët e sotme nganjëherë, mirëpo tani në një formë më ndryshe, sepse për të njëjtën çështje organizohen deri në 3 (tri) aktivitete/marshe në të njëjtën kohë dhe kërkesat variojnë, duke paraqitur kështu studentët, por edhe shoqërinë, si jo të unifikuar për qëllim të njëjtë;
- Fakti që Kosova ka qenë nën regjimin serb, ka ndikuar në krijimin e një lloj tradite rezistence dhe këmbënguljeje më të madhe për kërkesat, edhe pse në vitet '60 deri '90 komunikimi ka qenë shumë më i vështirë;
- Kanë ngritur shqetësimin se sot vërehet mungesë e vullnetit për të dalë në protesta, dhe se qytetarët hezitojnë t'i ngritin kërkesat e tyre;
- Potencuan dukurinë që gatishmëria jonë lidhet vetëm me ekstremet, sikur rrezikimi i ekzistencës dhe se jemi indiferentë ndaj çështjeve e problematikave me të cilat përballemi në përditshmëri, si arsimi, shëndetësia dhe shërbimet publike.



# ORGANIZATAT STUDENTORE RAJONALE

Për të krijuar një pasqyrë të qartë të aktivizmit studentor si dukuri, ishte e domosdoshme që vështrimi ta kapërcejë territorin e Kosovës, të zgjerohet në Shqipëri dhe Maqedoni, si mënyrë për t'i analizuar ngjashmëritë, dallimet dhe sfidat që studentët e të tri shteteve kanë hasur.

Për t'i shkëmbyer përvojat e këtyre dy shteteve fqinje me pjesëmarrësit e Shkollës Verore për Aktivizëm janë ftuar për të ligjëruar Elsad Lumaj dhe Petar Barlakovski.

## ***Aktivizmi studentor në Shqipëri***

Vështruar në aspektin kohor të viteve të fundit në Shqipëri, si aktori i vetëm i organizimit studentor, i cili ka ngritur çështje me rëndësi në fushën e arsimit, është "Organizata Politike" që për qëllim kyç ka luftimin e dukurisë së kthimit të universitetit në vendin ku blihet dija/diploma.

Reforma në arsim, filluar nga qeveria shqiptare, ka nxitur krijimin e lëvizjes studentore, përmes protestës së studentëve para kryeministrit, me numër masiv të pjesëmarrësve. Pas kësaj, gjatë vitit 2014 e më tej, protestat u kthyen në traditë të shprehjes së pakënaqësisë studentore, por duke mos arritur për fat të keq ta përmbushin qëllimin kyç, e që ishte që të mos zbatohet reforma e filluar.

Në Shqipëri, roli i studentëve dhe kompetenca për t'i paraqitur interesat e tyre pranë organeve udhëheqëse të Universitetit edhe pse formalisht mund të ekzistojnë, siç është p.sh.: Këshilli studentor, funksionimi, rëndësia dhe puna e tyre vihet në pikëpyetje nga studentët.

Lëvizja studentore vepron paralelisht Këshillit Studentor, sepse konsiderojnë se këshilli nuk ka bërë ndonjë gjë kundër reformës së 2014-ës, e gjithashtu kanë parë nevojën ta ngritin zërin kundrejt kësaj reforme, në mënyrë që ta ndalin implementimin në pika të caktuara edhe nëse nuk arrijnë ta ndalojnë në tërësi.

Sa u përket formave organizative/aktivitetëve, debatet, komunikimi i vazhdueshëm dhe tryezat kanë ndihmuar në mobilizimin e studentëve, edhe pse kohëve të fundit vërehet pasivizim i masës studentore, sepse reforma në arsim ka vjet që zbatohet si proces i ngadaltë dhe studentët e rinj nuk dinë mjaftueshëm për dëmet që mund të shkaktojë kjo reformë.

Pavarësisht që studentët aktivë në protesta dhe me qëndrime kundër reformës nuk kanë hasur hakmarrje në aspektin e notimit, lëvizja si e tillë nuk gëzon mbështetje nga pedagogët. Problematikë aktuale janë tarifatat e larta, për të cilat lëvizja pretendon se duhet të merren me urgjencë.

## **Aktivizmi studentor në Maqedoni**

Petar Barlakovski ka shpjeguar se sa i përket aktivizmit studentor në Maqedoni, nuk është se ka ndonjë historik të gjatë, por ishte mjaftueshëm i gjatë sa për të nxjerrë disa përfundime dhe rezultate të rëndësishme.

Në vitin 2004, "Youth Education Forum" është angazhuar që të nxjerrë në dritë e ta bëjë publike çështjen e korrupsionit brenda universiteteve. Parlamenti i studentëve kishte dy kandidatë, njëri nga partia opozitare dhe një nga partia në pozitë. Studentët kanë injoruar zgjedhjet në tërësi.

Sa i përket ideologjisë organizative dhe gjithëpërfshirjes në forumin e të rinjve, ata jo vetëm që kishin ide se si ta bënin ndryshimin, por ishin të përcaktuar edhe për mjetet dhe mënyrën se si do ta bënin duke përfaqësuar të gjithë studentët dhe interesat e tyre.

Gjatë 2009-ës, qeveria maqedonase njoftoi se do të ndërtojë një kishë të madhe në mes të sheshit në Shkup, kundër së cilës studentët e arkitekturës organizuan një protestë, për shkak se ndërtimi i saj ishte në kundërshtim me planin urbanistik të qytetit.

Qeveria maqedonase ishte represive ndaj kësaj nisme, studentët janë rrahur nga policia e janë kundërshtuar nga autoritetet kishtarë. Studentët filluan me mbledhjet e 10-15 personave në Universitet, u mobilizuan, pjesëmarrësit u konsideruan të barabartë dhe kjo çoi në rritjen e numrit të njerëzve që u janë bashkëngjitur, duke kapur kështu 10.000 protestues në total.

Është e rëndësishme që gjërat të ndryshohen, idetë të përçohen te njerëzit që ata të mund ta përfshijnë veten në nisma të cilat mbrojnë interesat e tyre të prekura në njërin apo formën tjetër.

Ka zgjatur diku rreth dy muaj qëndrimi në zonën e Universitetit, e quajtur nga studentët protestues si zonë autonome në të cilën policia s'kishte të drejtë të ndërhynte, të cilën e përkrahën shumë nga profesorët, qytetarë, madje i janë bashkëngjitur edhe nxënës të shkollave të mesme.

Pas zgjedhjes së rektorit dhe mbajtjes së zgjedhjeve për parlamentin studentor, studentët ishin të pakënaqur dhe dyshonin në transparencën e votimit/numërimit. Protestat lidhur me këtë çështje nuk gjetën përkrahje nga masa qytetare dhe policia u ndesh me protestuesit.

Për shkak të angazhimit të studentëve dhe kërkesave të tyre, ata janë përfshirë në hartimin e ligjit të ri për arsimin e lartë, bashkë me profesorët.

# GJENDJA AKTUALE NË FUSHËN E ARSIMIT

Kur flasim për gjendjen aktuale në vend sa i përket fushës së arsimit të lartë, një analizë e tillë do të ishte e mangët në qoftë se nuk merren për bazë të dhënat statistikore, për të na dhënë një pasqyrë më reale të gjendjes aktuale.

Mbi të dhënat statistikore në vend për fushën e arsimit të lartë, por edhe për procesin e Bolonjës, ka ligjëruar Dukagjin Pupovci<sup>6</sup>. Nga të dhënat e paraqitura për gjendjen aktuale në fushën e arsimit të lartë, kuptojmë se Kosova i ka rreth 130 mijë studentë, apo ndryshe 7471 studentë për 100 mijë banorë. Në anën tjetër, BE-ja i ka më pak se 4 mijë studentë në 100 mijë banorë. Një numër kaq i lartë i studentëve në raport me 100 mijë banorë e rendit Kosovën në vendin e 8 (tetë) në botë për nga numri i studentëve.

Megjithatë, rritja e shpejtë e numrit të studentëve, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, nuk është përcjellë me rritje proporcionale të stafit akademik. Si pasojë, numri i stafit akademik është i pamjaftueshëm, dhe pjesëtimi “mësimdhënës - student” në nivel të vendit është 1:42. Nëse fokusohemi vetëm në arsimin publik, atëherë pjesëtimi “mësimdhënës - student” është 1:58.

Statistikat kanë vënë në pah edhe raportin “femra - meshkuj”, ku është vërejtur se në universitete publike, pjesëmarrja e femrave është më e lartë se e meshkujve, kurse në ato private është e kundërta. Njëkohësisht, pavarësisht rezultateve të femrave përgjatë studimeve, papunësia dhe joaktiviteti është shumë herë më i lartë te femrat sesa te meshkujt.

Studentët kanë diskutuar mbi këtë dukuri shoqërore dhe kryesisht është vënë theksi mbi diskriminimet gjinore dhe pabarazinë në vend. Sipas tyre, në përgjithësi familjet kosovare shfaqin më shumë gatishmëri që të investojnë në shkollimin e djemve sesa të vajzave. Sa i përket papunësisë dhe joaktivitetit të lartë të femrave në vend, u përmend emancipimi i gruas në shoqëri si një domosdoshmëri për ndryshimin e gjendjes aktuale në vend.

6 Drejtor ekzekutiv i KEC (Kosovo Education Center), njohës i fushës së arsimit dhe statistikave.

# PROCESI I BOLONJËS

*Për procesin e Bolonjës, Dukagjin Pupovci, ka ndarë detaje mjaft interesante me studentët dhe ka shpjeguar fazat e ndryshme të këtij procesi, qysh nga fillimi deri më sot si dhe praktikën e zbatimit në Kosovë.*

## **Historik i shkurtër**

Shtetet evropiane filluan të mendojnë më tepër rreth zhvillimit të arsimit, për shkak se sa herë që studentët lëviznin nga njëri shtet i BE-së në tjetrin, hasnin në probleme të ndryshme. Prandaj, përafrimi i sistemeve të arsimit të lartë ndërmjet shteteve anëtare është konsideruar i domosdoshëm, në mënyrë që të mos ketë barriera ndërmjet studentëve që kanë studiuar në një shtet anëtar, e pastaj me atë shkollim duan të gjejnë punë në shtetin tjetër.

Kështu, më 19 qershor 1999, përmes procesit të Bolonjës u krijua hapësira evropiane e arsimit të lartë. Deklarata e Bolonjës u nënshkrua fillimisht nga 29 shtete evropiane, e më vonë i janë bashkëngjitur shtetet e tjera evropiane dhe disa shtete aziatike të ish-BRSS-së. Pra, të gjitha shtetet evropiane dhe disa shtete aziatike janë anëtare të procesit të Bolonjës, përveç Kosovës.

Zotimi i kësaj deklarate ka qenë që shtetet nënshkruese ta bëjnë përafrimin, e jo “standardizimin” apo “unifikimin” e sistemeve evropiane të arsimit të lartë.

## **Definicione që lidhen me procesin e Bolonjës**

Shtetet nënshkruese të Bolonjës, pasi morën obligimin që të bashkëpunojnë mes vete, vendosën të organizojnë takime të rregullta të vendeve anëtare. Këto shtete takohen 1 (një) herë në 2 (dy) vjet. Krahas këtyre takimeve, ekziston një mekanizëm i quajtur “Bolonja Follow Up Group”, në të cilin marrin pjesë përfaqësuesit e shteteve nënshkruese dhe disa organizata ndërkombëtare, siç janë Këshilli i Evropës, Asociacioni i Universiteteve Evropiane, etj., që takohen 2 (dy) herë brenda vitit.

## **Objektivat që u parashtruan në procesin e Bolonjës janë:**

- Aprovimi i një sistemi të gradave lehtë të kuptueshme dhe të krahasueshme, me përdorimin e shtojcës së diplomës;
- Vendosja e një sistemi të bazuar kryesisht në dy cikle, baçelor dhe master;
- Vendosja e sistemit të pikëve ECTS;
- Promovimi i mobilitetit;
- Promovimi i bashkëpunimit evropian në fushën e sigurimit të cilësisë;
- Promovimi i Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë;

**Pas Samitit të Pragës në vitin 2001, dhe atij të Berlinit në vitin 2003, shtohen edhe 4 (katër) objektiva të tjera, përveç këtyre 6 (gjashtë) që Procesi i Bolonjës i kishte tashmë:**

- Promovimi i mësimit gjatë gjithë jetës, apo ndryshe “flexible learning patterns”;
- Përputhje e reformave në arsimin e lartë, në të cilin përfshihen edhe studentët, e jo vetëm institucionet e arsimit të lartë, respektivisht ministritë e arsimit;
- Promovimi i atraktivitetit të Hapësirës Evropiane të arsimit të lartë, në mënyrë që të krijohet perceptimi se të studiosh në Evropë është diçka atraktive, në mënyrë që të tërhiqen studentë nga vende të ndryshme të botës;
- Futjen e studimit të doktoratës për herë të parë, meqë deri në atë kohë niveli i fundit konsiderohej niveli master, e më pas mbrojtja e një punimi konsiderohej si doktoraturë.

Synim tjetër që dëshirohet të arrihet prej shteteve nënshkruese të Bolonjës është përforsimi i sigurimit të cilësisë ndërmjet shteteve anëtare. Kjo arrihet përmes agjencioneve të akreditimit që i ka secili shtet, puna e të cilave është akreditimi i institucioneve dhe programeve. Vetë këto agjenci akreditohej prej ENQA-s (European Association for Quality Assurance in Higher Education), ndryshe rrjeti evropian i agjencive të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë, anëtare e së cilës është edhe Agjencia Kosovare e Akreditimit. Në rast se një agjenci akreditohet nga ENQA, atëherë akreditimet e bëra nga ajo agjenci konsiderohen të besueshme në Evropë. Mirëpo, kjo besueshmëri e agjencive të akredituara nga ENQA testohet 1 (një) herë në 5 (pesë) vjet. Prandaj, akreditimi i bërë nga ENQA mund të humbet, dhe një agjenci kryesisht konsiderohet si jokredibile në rast se hidhen dyshime mbi paanshmërinë e saj në akreditimet që bën.

Një element i rëndësishëm i Procesit të Bolonjës është “rezultatet e të nxënit”. Kjo ka të bëjë me përafrimin e rezultateve të të nxënit, apo ndryshe thënë, një student që ka studiuar mjekësinë në një shtet anëtar duhet të ketë rezultate të përafërta të të nxënit me një student tjetër të së njëjtës degë, në një shtet tjetër anëtar. Për t’u arritur kjo, çdo program mësimor duhet t’i ketë “learning outcomes”, apo atë se çka në fund të programit duhet të dijë një student.

## ***Kosova dhe procesi i Bolonjës***

Deklarata e Bolonjës në vitin 1999 e gjen arsimin e lartë në Kosovë në fazën e rikthimit në objektet e veta, më parë të uzurpuara, dhe në përpjekjet për konsolidimin e procesit mësimor. Kosova, siç është theksuar më lart, është vendi i vetëm evropian që nuk është anëtar i Procesit të Bolonjës. Pavarësisht që nuk është anëtare, Kosovës i është lejuar të jetë e pranishme në çdo samit të ministrave deri në vitin 2007. Por, me ta shpallur pavarësinë, në vitin 2008, nuk është lejuar më as prania e saj.

Megjithatë, Kosova është ndër vendet e para që ka filluar ta zbatojë në praktikë Deklaratën e Bolonjës. Por, një zbatim të tillë e ka bërë në formë krejt të papërgaditur. Qysh në vitin 2001 është futur në aplikim përdorimi i kredive apo pikëve ECTS, mirëpo përcaktimi i kredive për lëndë nuk është bërë në përputhje

me rëndësinë dhe vështirësinë e lëndës, por varësisht prej tekave të profesorëve që e kanë ligjëruar atë lëndë. Madje, për një periudhë të caktuar, për t'i shmangur konfliktet mes profesorëve, të gjitha lëndët i kanë pasur 6 kredi. Në anën tjetër, është keqinterpretuar përcaktimi i bërë nga procesi i Bolonjës për ciklin e parë të studimeve, dhe si pasojë, Kosova dhe Shqipëria, për një periudhë të caktuar kohore, kanë qenë shtetet e vetme në të cilat Fakulteti Juridik ka qenë 3 (tre) vjet, e jo 4 (katër) siç është në të gjitha shtetet e tjera anëtare. Me ta kuptuar dëmin e bërë, drejtimi i Fakultetit Juridik pas një kohe kthehet në sistemin 4 (katër)-vjeçar, siç kishte qenë më parë. Një tjetër dëm i shkaktuar përgjatë aplikimit të procesit të Bolonjës në praktikë ka qenë edhe bartja e lëndëve të baçelorit në gradën master. Ose, në raste të tjera, duke mos e kuptuar mirë ndarjen në dy cikle, shpeshherë të njëjtat lëndë të nivelit baçelor janë ligjëruar në master.

# STUDENTËT DHE AKTIVIZMI STUDENTOR

## *Puna në grupe*

Pjesëmarrësit janë ndarë në 6 grupe punuese dhe kanë pasur për detyrë që përmes planit të “organizatës së tyre” t’u përgjigjen këtyre pyetjeve:

1. Çka i duhet një organizate bashkëkohore?
2. Çfarë metoda të organizimeve duhet të përdoren?
3. Cilat çështje duhet ngritur apo çfarë kauza duhet të ketë?

Si problematika ende të pranishme në këndvështrimin e studentëve mbesin: ngacmimet seksuale, plagjiatura, nepotizmi në përbërjen e stafit akademik, imponimi i blerjes së librave të profesorëve, parregullsia në mbajtjen e ligjëratave, provimeve dhe konsultimeve, vonesat e pajustificuara të profesorëve, anulimet e provimeve dhe/apo konsultimeve pa paralajmërime paraprake, etj.

Për ta nxitur bashkëpunimin ndërmjet studentëve dhe përafrimin e tyre për çështjet me interes, janë zhvilluar disa aktivitete në grup, gjatë të cilave studentët kanë paraqitur preferencat e tyre për format e ndryshme të organizimit, kauzat për të cilat do të donin të punonin në të ardhmen, hezitimin që për këto kauza të bashkëpunojnë me organizatat studentore aktuale në UP, etj. Krahas kësaj, kanë shprehur edhe kreativitetin e tyre sa u përket mjeteve, metodave, parullave të caktuara, që do të mund t’i përdornin në mënyrë që ta tërheqin edhe vëmendjen e publikut të gjerë.

Studentët diskutuan mbi format e mundshme të organizimit studentor dhe për atë se çfarë i duhet secilës prej formave. Janë identifikuar gjithsej 4 (katër) forma, si opsione të përshtatshme:

1. Lëvizja;
2. Organizata formale;
3. Klubi;
4. Grupi

## *Lëvizja studentore*

### *Lëvizja studentore si formë e organizimit studentor*

Lëvizja studentore si një ndër format e organizimit studentor, është konsideruar si ndër më të përshtatshmet.

Në pyetjen “çka i nevojitet një lëvizjeje studentore?” përgjigjet kanë qenë që një lëvizje ka nevojë për: misionin, vizionin, rregullat, planin e aktiviteteve, objektiva, hapësirën, emrin dhe anëtarët.

Secila formë e organizimit ka nevojë për një mision të caktuar, megjithatë çka është karakteristike për lëvizjen është se misioni i lëvizjes mund të jetë shumë më i gjerë dhe gjithëpërfshirës, kurse format e tjera të organizimit, si organizata formale, klubi apo grupi, kanë nevojë për një mision më të ngushtë dhe konkret për nga natyra, por po aq i rëndësishëm për shoqërinë. Prandaj,

lëvizjet studentore kanë potencial të jenë më gjithëpërfshirëse. Disa organizata, grupe e klube mund të jenë pjesë e një lëvizjeje.

Krahas misionit, lëvizja duhet ta ketë të përcaktuar vizionin e saj, në mënyrë që ta vizualizojë mënyrën se si do t'i përmbushë kauzat e saj.

Lëvizja duhet të ketë rregulla të përcaktuara në bazë të të cilave duhet të funksionojë, dhe të përpilojë paraprakisht një plan të aktiviteteve që synon ta realizojë brenda periudhave të caktuara kohore.

Njëkohësisht, lëvizja duhet t'i ketë të qarta objektivat e veta, ta ketë hapësirën e caktuar të përshtatshme për aktivitete, emrin, i cili preferohet të jetë domethënës dhe kreativ, si dhe anëtarët të cilët ndajnë interesa të përbashkëta që duan t'i arrijnë.

## ***Kauzat për të cilat mund të luftojë lëvizja studentore***

Në pyetjen “çfarë kauzash mund të ketë një lëvizje studentore?” përgjigjet kanë qenë: **cilësia në arsim, luftimi i korrupsionit, fuqizimi i studentëve, promovimi i aktivizmit studentor, universiteti të mbetet publik, barazia dhe integriteti akademik.**

**Cilësia në arsim** është përmendur si një ndër kauzat kyçe për të cilat do të duhej të luftonte një lëvizje studentore. Me këtë është nënkuptuar nevoja për literaturë bashkëkohore, për më shumë hapësira leximi, etj.

Një tjetër kauzë për të cilën do të duhej të luftonte lëvizja studentore është **antikorrupsioni**, apo luftimi i korrupsionit brenda universitetit. Prania e nepotizmit brenda stafit akademik është një problematikë mjaft e shprehur në universitet, andaj studentët pjesëmarrës kanë qenë të mendimit se një dukuri e tillë duhet të ndalohet.

Me fuqizimin e studentëve është nënkuptuar **fuqizimi i rolit të studentëve** brenda universitetit. Pavarësisht se në Universitetin e Prishtinës një numër i caktuar i ulëseve në Senat iu takon përfaqësuesve të studentëve, studentët kanë Parlamentin Studentor, ka disa organizata studentore, etj., përshtypjet e studentëve janë se në fakt këto organizata studentore kanë ngjyrimë partiake dhe kryesisht punojnë për arritjen e interesave të tyre personale apo partiake, duke i përdorur studentët e tjerë si marioneta në arritjen e qëllimeve të tyre.

Prandaj, studentët janë të mendimit se nuk e gjejnë një përfaqësim të denjë të këto organizata. Rrjedhimisht, kanë ardhur në përfundimin se fuqizimi i rolit të studentit në universitet është i domosdoshëm për shtyrjen përpara të interesave të studentëve. Këtu hyn edhe **promovimi i aktivizmit studentor**, për shkak se është potencuar se si shkak i gjendjes në universitet është edhe pasivizmi i studentëve, pavarësisht situatës shqetësuese.

Prandaj, duhet të punohet në atë drejtim që studentët të jenë më aktivë dhe ta ngritin zërin pa hezitim për çështjet që i brengosin.

Kauza që **universiteti të jetë publik** nënkupton që pavarësisht se tarifat nuk janë konsideruar si problematike, siç ndodh me vendet e rajonit që kanë tarifa të larta të studimeve, universiteti duhet ta ruajë këtë formë dhe të mos punojë në drejtim të ngritjes së tarifave.

**Barazia** është kauzë për të cilën duhet punuar më shumë brenda universitetit, e me këtë ndër të tjera është nënkuptuar ofrimi i mundësive të barabarta për të gjithë.

**Integriteti akademik** është një tjetër kauzë e rëndësishme e përmendur nga studentët. Literatura përplot plagjiaturë, skriptat si rrugë e shkurtër për kalimin e provimeve, kopjimet nga ana e studentëve, e profesorë që emërohen si staf akademik pa i përmbushur kriteret minimale, janë dukuri që duhet luftuar.



## ***Mjetet e ndikimit që mund të përdoren nga lëvizja studentore***

Si mjete të ndikimit të cilat mund të përdoren nga lëvizja studentore janë identifikuar: **hulumtimet, komunikimi publik, monitorimi, protesta, bllokimi, aksionet simbolike, fushatat vetëdijësuese dhe peticionet.**

Kur është parashtruar grantimi i lëvizjeve studentore si problematikë që e përcjell lëvizjen, sipas studentëve, shumë prej mjeteve apo metodave kërkojnë pak ose aspak të holla. Komunikimi publik është lehtësuar dukshëm nga rrjetet sociale, andaj edhe është i mundur informimi i publikut pa pasur nevojë për fonde.

Hulumtimet dhe monitorimet janë mjeti i duhur për të analizuar një problem të caktuar, në mënyrë që të arrijmë deri te të gjeturat reale për gjendjen në vend. Protestat, bllokimet, aksionet simbolike, etj., mund të kërkojnë shuma të vogla të të hollave, për mbulimin e shpenzimeve të realizimit të parullave, pamfletave, etj.

## ***Organizata formale***

### ***Organizata formale si formë e organizimit studentor***

Në pyetjen “çfarë i duhet një organizate formale?” përshtypjet e studentëve janë që organizatës formale i duhet: **misioni, vizioni, statuti, strategjia afatmesme dhe afatgjatë, projektet, grantimi, hapësira, hierarkia, dhe simbolet identifikuese.**

Organizata formale, sikurse lëvizja, duhet ta ketë të qartë misionin e saj, e me këtë edhe vizionin se si do të arrihet përmeshja e misionit që ka. Ndryshe prej lëvizjes që ka rregulla të caktuara, organizata formale, pavarësisht se a është shoqatë apo fondacion, duhet ta ketë **statutin** e saj.

Organizata formale duhet ta ketë të përcaktuar qartë strategjinë afatmesme dhe afatgjatë, pra, ta dijë se cilat janë aktivitetet që do t'i realizojë brenda periudhave të caktuara kohore. Projektet e organizatës duhet të jenë të planifikuara në detaje, për shkak se varësisht nga mënyra e planifikimit, varet edhe grantimi. Një planifikim i paqartë i shpenzimeve të një projekti ndikon negativisht në realizimin e tij.

Organizata formale e ka të domosdoshme të ketë një **hapësirë** të caktuar ku i ushtron aktivitetet e saj. Po ashtu, organizata formale ka **hierakinë** e brendshme, gjë që mungon te lëvizja studentore si formë e organizimit studentor.

Organizata formale duhet ta ketë **emrin dhe simbolin** e saj, në mënyrë që lehtësisht të identifikohet dhe të dallohet nga të tjerat.

Organizata formale si formë e organizimit studentor ka gjetur përkrahje më të madhe, sipas opinioneve të studentëve, për shkak se vendimmarrja në organizata formale është më e lehtë, për shkak të hierarkisë që e ka. Një tjetër përparësi është grantimi i projekteve të ndryshme.

Megjithatë, pavarësisht lehtësive që i sjellë formalizimi i organizatës, sa i përket vendimmarrjes dhe grantimit të projekteve, studentët janë treguar skeptikë kundrejt organizatave formale, duke menduar se me një hierarki të brendshme lind edhe rreziku i shfrytëzimit të studentëve nga persona të caktuar, për interesat e tyre personale që mund t'i kenë. Kështu, organizatat formale do t'iu shërbenin interesave personale të grupeve të caktuara brenda organizatës, duke i lënë brengat e studentëve në rend të dytë.

## ***Kauzat për të cilat mund të luftojë organizata formale***

Si çështje me interes për studentët, në kuadër të organizatave formale, janë identifikuar: ngritja e cilësisë në arsim, luftimi i korrupsionit dhe nepotizmit brenda UP-së, fuqizimi i studentit dhe rolit të tij në vendimmarrje brenda UP-së dhe njëkohësisht promovimi i aktivizmit studentor si një domosdoshmëri për të shtyrë në vazhdimësi përpara çështje me interes, që universiteti të mbetet publik, të avokohet për barazi, si dhe të luftohet për integritet akademik.

Këtu pra vijmë në përfundimin se kauzat për të cilat mund të luftojë lëvizja studentore dhe organizata formale janë të njëjta, mirëpo mund të dallojnë për nga mënyra e realizimit të tyre.

## ***Mjetet e ndikimit që mund të përdoren nga organizatat formale***

Si mjete të ndikimit të cilat mund të përdoren nga organizatat formale janë identifikuar: hulumtimet, komunikimi publik, monitorimi, protesta, bllokimi, aksionet simbolike, fushatat vetëdijësuese, peticionet, trajnimet dhe punëtoritë.

Këtu vërejmë dukshëm një ngjashmëri ndërmjet mjeteve që mund të përdoren nga lëvizjet studentore dhe nga organizatat formale, me një përparësi të organizatave formale në organizimin e trajnimeve dhe punëtorive të ndryshme. Megjithatë, organizimi i trajnimeve dhe punëtorive nuk është i domosdoshëm për ngritjen e vetëdijes shoqërore dhe për nxitjen e zhvillimit të aktivizmit studentor. Andaj, duke marrë parasysh përparësitë e lëvizjes studentore si formë e aktivizmit studentor, si p.sh.: mungesa e hierarkisë të brendshme, joformaliteti që e karakterizon lëvizjen, gjithëpërfshirja e grupeve të ndryshme, etj., studentët kanë favorizuar

në përgjithësi lëvizjen studentore kundrejt organizatës formale.

## ***Klubet studentore***

### ***Klubi si formë e organizimit studentor***

Klubet si formë tjetër e organizimit studentor kanë gjetur përkrahje, mirëpo në përshtypjen e studentëve, klubet në fakt më tepër kanë **karakter rekreacioni**. Një grup i personave me hobi apo pasione të njëjta mund të formojë një klub, por klubet nuk paraqesin formën e duhur të organizimit për t'i shtyrë përpara ndryshimet e nevojshme në universitet. Klubet formohen për të përmbushur një qëllim të caktuar. Për përmbushjen e rolit të klubit nevojitet hapësira e veçantë ku ata mund t'i ushtrojnë aktivitetet e tyre dhe klubi duhet ta ketë emrin identifikues.

Për shkak të natyrës së veçantë, varësisht nga lloji i klubit, ai mund të ketë nevojë për rregulla të ndryshme mbi të cilat funksionon, si dhe pajisje të ndryshme, p.sh.: një klub i filmit ka nevojë për projektor dhe hapësira të veçanta.

Klubi duhet ta ketë anëtarësinë e tij të rregullt, megjithatë, për shkak të formës që kanë, klubet janë të prirura të shuhen shpejt.

### ***Kauzat për të cilat mund të luftojë klubi***

Kur bëhet fjalë për klubet, ato janë më pak formale, prandaj edhe kauzat e tyre mund të jenë të llojit si rekreacioni, socializimi i studentëve me hobi apo pasione të njëjta, dhe edukimi joformal për temat të cilat i përzgjedhin vetë anëtarët e klubit.

## ***Mjetet e ndikimit që mund të përdoren nga klubi***

Si mjete të ndikimit të cilat mund të përdoren nga klubet janë identifikuar: **fushatat vetëdijësuese, takimet e rregullta dhe aktivitetet e caktuara.**

Fushatat vetëdijësuese mund të përdoren si mjet i cili e ngrit vetëdijen shoqërore për një çështje të caktuar, me interes për studentët.

Takimet e rregullta ndërmjet studentëve apo tryezat e diskutimeve janë po ashtu një mjet i përshtatshëm që mund të gjejë përdorim nga klubet për të diskutuar mbi çështjet që i brengosin studentët.

Aktivitetet e ndryshme me karakter rekreacioni mund të jenë të dobishme për studentët, respektivisht anëtarët e klubit.

## ***Grupet studentore***

### ***Grupet si formë e organizimit studentor***

Grupet në anën tjetër e kanë të domosdoshme ta kenë të konkretizuar një **qëllim** që duan ta arrijnë, pra të kenë të përcaktuar një interes të përbashkët i cili i bashkon anëtarët. Grupet për nga organizimi i brendshëm nuk kanë hierarki, pra ngjajnë me lëvizjet. Mirëpo, zakonisht grupet kanë qëllime specifike të konkretizuara, andaj misioni i tyre është më i ngushtë, kështu që për nga numri i anëtarëve, grupet kryesisht janë më të vogla se lëvizjet. Zakonisht, pas përmbushjes së qëllimit të caktuar, grupet kanë tendencë të shuhen.

## ***Kauzat për të cilat mund të luftojë grupi***

Grupet si kauza mund të kenë **socializimin** e anëtarëve të grupit, si dhe **vetëdijësimin** e shoqërisë për çështjet me interes për ta, p.sh.: grupi antiseksist mundohet ta ngritë zërin dhe vetëdijësimin në shoqëri për ngacmimet seksuale, se sa janë të pranishme ato, dhe si të luftohet kjo dukuri negative e pranishme në UP.

## ***Mjetet e ndikimit që mund të përdoren nga grupi***

Si mjete të ndikimit që mund të përdoren nga grupet janë identifikuar: diskutimet, mbledhjet apo takimet.

Diskusimet janë mjet i përshtatshëm për t'i shtjelluar problematikat me të cilat ballafaqohen studentët, dhe për zgjidhjet e mundshme për ta përmirësuar gjendjen e tyre.

Takimet e rregullta ndërmjet anëtarëve të grupit janë po ashtu të dobishme dhe kontribuojnë në funksionimin e mirëfilltë dhe mbarëvajtjen e grupit.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur propozimet e dhëna nga studentët për format e organizimeve të aktivizmit studentor; për çfarë ka nevojë secila prej formave; cilat janë kauzat mbi të cilat mund të punojnë; dhe cilat metoda mund t'i përdorin.

Shkolla Verore për Aktizimin Studentor	LËVIZJE	ORGANIZATË FORMALE	KLUB	GRUP
<p><b>Çka i duhet secilës prej formave të organizimit studentor?</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Misioni</li> <li>- Vizioni</li> <li>- Rregullat</li> <li>- Plani i aktiviteve</li> <li>- Objektivat</li> <li>- Hapësirë</li> <li>- Emri</li> <li>- Anëtarë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Misioni</li> <li>- Vizioni</li> <li>- Statuti</li> <li>- Strategjia afatmesme dhe afatgjatë</li> <li>- Projektet</li> <li>- Grantimi</li> <li>- Hapësirë</li> <li>- Hierarkia</li> <li>- Simbolet</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qëllimi</li> <li>- Hapësira</li> <li>- Emri</li> <li>- Rregullat</li> <li>- Paisjet, rekuizitat</li> <li>- Anëtarësia e rregullt</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qëllim</li> <li>- Anëtarë</li> </ul>
<p><b>Çfarë kauzash apo çështjesh mund të trajtojë?</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Cilësia</li> <li>- Antikorrupsioni</li> <li>- Fuqizimi i studentit, promovimi i aktivizimit studentor</li> <li>- Universiteti Publik</li> <li>- Barazia</li> <li>- Integriteti akademik</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Cilësia</li> <li>- Antikorrupsioni</li> <li>- Fuqizimi i studentit, promovimi i aktivizimit studentor</li> <li>- Universiteti Publik</li> <li>- Barazia</li> <li>- Integriteti akademik</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rekreacioni</li> <li>- Socializimi</li> <li>- Edukimi joformal</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Socializimi</li> <li>- Vetëdijësimi</li> </ul>
<p><b>Çfarë metodash mund të përdorë?</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hulumtimi</li> <li>- Komunikimi publik</li> <li>- Monitorimi</li> <li>- Protesta, bllokim, aksione simbolike</li> <li>- Fushatat vetëdijësuese</li> <li>- Peticionet</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hulumtimi</li> <li>- Komunikimi publik</li> <li>- Monitorimi</li> <li>- Protesta, bllokim, aksione simbolike</li> <li>- Fushatat vetëdijësuese</li> <li>- Peticionet</li> <li>- Trajnimet</li> <li>- Punëtoritë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Fushata vetëdijësuese</li> <li>- Takime të rregullta</li> <li>- Aktivitete të caktuara</li> </ul>	

**Studentët i janë përgjigjur pyetjes: Në çfarë forme do t'ju hyjnë në punë njohuritë e fituara në këtë shkollë verore?**

**Në këtë pyetje, studentët pjesëmarrës kanë zgjedhur midis disa opsioneve, me ç'rast ndër përgjigjet më të shpeshta kanë qenë:**

- Kategoria më e zgjedhur ishte **aktivizmi studentor** (22). Kjo kategori përfshin: aktivizëm studentor, ndryshim të gjendjes në Universitet, reagim ndaj parregullsive, angazhim studentor, organizimi studentor.
- Kategoria e dytë më e zgjedhur është **organizatë/projekt** (7). Këtu hyjnë hapja e një organizate, aplikim për ndonjë projekt.

**Më poshtë janë të listuara disa nga përgjigjet e dhëna nga studentët pjesëmarrës:**

*“Aktivizmi studentor është ajo e cila duhet të na përcjellë neve si studentë gjatë tërë studimeve tona, kështu që në këtë mënyrë njohuritë që kemi arritë t'i marrim gjatë këtyre 5 ditëve do të kemi mundësi t'i zbatojmë.”*

*“Krijimi i një ideje të qartë rreth aktivizmit studentor, të cilin do të mundohemi ta përdorim për përmirësimin e gjendjes së universitetit.”*

*“Në reagimin ndaj këtyre situatave që kemi diskutuar, që kur e shoh një dukuri negative që po ndodh në UP me reagu ndaj saj e jo me heshtë.”*

*“Pas shkollës verore, tani kam diapazon më të gjerë të njohurive rreth aktivizmit studentor dhe rëndësinë që ka në shoqëri. Të gjitha këto do të më ndihmojnë që më lehtë të vendos për të marrë iniciativë dhe problemet e studentëve t'i shoh më ndryshe nga herët e kaluara.”*

# PËRFUNDIMET

## Përfundimet e arritura janë:

- Organizatat studentore kanë dështuar në përfaqësimin e denjë të interesave të studentëve.
- Organizatat studentore shihen si duar të zgjata të partive politike apo grupeve të tjera të interesit.
- Ka një mungesë të theksuar të gatishmërisë së studentëve dhe qytetarëve që përmes protestave/demonstratave ose formave të tjera të aktivizmit ta ndryshojnë gjendjen në vend;
- Aktivizmi studentor dhe qytetar ka qenë më i përhapur në vitet 60-ta deri në vitet e 90-ta, pavarësisht vështirësive që kanë pasur në organizim dhe mobilizim.
- Shkak i dyshimit dhe skepticizmit të theksuar të studentëve kundrejt organizatave studentore të tanishme në Universitet është frika se do të përdoren në emër të aktivizmit për t'i përmbushur interesat personale të personave/partive të ndryshme.
- Vendet e rajonit ballafaqohen me probleme të natyrave të tjera, si: tarifat e larta apo fuqia e vogël vendimmarrëse e studentëve brenda universiteteve.
- Statistikat e shfaqura për arsimin në Kosovë u ka ndihmuar të kuptojnë më qartë se ku qëndrojmë në raport me vendet e tjera.
- Resurset publike po keqpërdoren.
- Problem i vazhdueshëm ende janë diplomat dhe plagjiaturat e stafit akademik të UP-së.
- Ka pak aktivitete që inkuadrojnë studentë të fakulteteve të ndryshme, duhet të ketë “diçka” që bashkon studentët e të gjitha njësive akademike nga pak.
- Format e organizimit pa hierarki të brendshme, si p.sh. lëvizjet apo grupet studentore, janë më të përshtatshme për shkak se të gjithë anëtarët janë të barabartë.
- Çështja e fondeve/grantimit që sjellin format joformale, si lëvizja, klubi apo grupi janë problematike.
- Të shmangen format e organizimit që kërkojnë shumë formalitete, si p.sh.: regjistrimi në ministrinë përkatëse që kërkohet tek organizatat formale.
- 19 prej 34 studentëve kanë theksuar që do të bënin të njëjtën punë/studionin të njëjtin profesion edhe nëse nuk do të duhej të brengoseshin për banim dhe shpenzime të jetesës, kurse të tjerët potencuan që kanë diskrepancë mes asaj çka kanë dashur të jenë dhe asaj çfarë janë.

# REKOMANDIMET

## Rekomandimet e nxjerra janë si më poshtë:

- Hisedarët duhet të angazhohen në aktivizimin e studentëve për çështjet me interes dhe promovimin e aktivizimit studentor.
- Hisedarët duhet t'i shfrytëzojnë përparësitë e kohës së sotme sa i përket organizimit dhe mobilizimit, siç është shfrytëzimi i komunikimit përmes mediave vendore dhe rrjeteve sociale.
- Hisedarët duhet të angazhohen në drejtim të pavarësisht të Universitetit nga ndikimet dhe ngjyrimet partiake.
- Hisedarët duhet të angazhohen në drejtim të përmirësimit të gjendjes në Universitet, pasurimit me literaturë cilësore e bashkëkohore, mbrojtjen e integritetit akademik, shtimin e hapësirave të veçanta për lexim, etj.
- Hisedarët duhet të angazhohen në vazhdimësi që përmes hulumtimeve, monitorimeve, apo metodave të tjera, ta përcjellin gjendjen në Universitet, në mënyrë që të kenë një pasqyrim real përmes gjetjeve mbi situatën në të.
- Hisedarët duhet të sigurohen që resurset publike të shfrytëzohen në mënyrën e duhur dhe të jenë vigjilentë ndaj asaj se ku po shpenzohet paraja publike.
- Hisedarët duhet të angazhohen që në vazhdimësi të luftohet plagjiatura nëpër tekstet akademike dhe të rritet cilësia e punimeve shkencore.
- Hisedarët duhet të angazhohen që të krijojnë hapësirë për aktivitete të ndryshme që do t'i bashkonin studentët e Fakulteteve të ndryshme, në mënyrë që t'i ndajnë eksperiencat e tyre.
- Hisedarët duhet të angazhohen drejt formimit të një lëvizjeje gjithëpërfshirëse ose grupi studentor, që do t'i përfaqësonte denjësisht interesat e studentëve.
- Hisedarët duhet të sigurohen që mungesa e fondeve/granteve e pranishme si problematikë të format joformale të organizimeve studentore, të mos jenë shkak i mosaktivizimit studentor, andaj hisedarët duhet t'i përdorin të gjitha mjetet që kërkojnë pak ose aspak të holla për ta përmirësuar gjendjen aktuale.
- Hisedarët duhet të angazhohen që të kenë programe të orientimeve për studime përpara se studentët të kyçen në studime në Universitetin e Prishtinës apo njësive të tjera.

ORCA është anëtare e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet - KITU, mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur - KFOS. Ky raport është pjesë e programit të KITU-së. Ky grant është realizuar me përkrahjen e projektit Sfidimi i Korrupsionit në Arsimin e Lartë i financuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Përmbytja është përgjegjësi e ORCA dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i KFOS-it.

